



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 174, Datë 04.11.2020

“MBI
LICENCIMIN E SHOQËRISË “TIRANA ENERGJI“ SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”.

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “d” të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”; të ndryshuar, neneve 4, pika 1, gërma “e”; 5 pika 1, gërma “e” dhe nenit 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, të ndryshuar dhe nenit 15 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 04.11.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 116/1 prot, datë 22.10.2020, e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, mbi licencimin e shoqërisë “Tirana Energji” shpk., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 138, datë 21.08.2020, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “Tirana Energji” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Në vijim të kësaj vendimmarrje u krye njoftimi në median e shkruar me shkresën nr. 62/26 prot, datë 25.08.2020, dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “Tirana Energji” sh.p.k.
- Me shkresën nr. 997/1 prot, datë 26.08.2020, ERE i’u drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar.
- Shoqëria “Tirana Energji” sh.p.k., në përgjigje të ERE-s me shkresën nr. 997/3, datë 10.09.2020, ka përcjellë kryesisht dokumentacionin përkatës, por duke qënë se u konstatua ende mungesë dokumentacioni ERE me shkresën nr. 997/4 prot, datë 22.09.2020, iu drejtua sërish shoqërisë për pjesën e mbetur. Shoqëria në përgjigje të sa më sipër, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 997/5 prot, datë 15.10.2020, ka përcjellë dokumentacionin e kërkuar.

- Shoqëria “Tirana Energji” sh.p.k., është regjistruar pranë QKB-së në datën 07.08.2017, konform Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për qendrën kombëtare të biznesit” (QKB) me statusin e Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k).
- Aplikimi i shoqërisë “Tirana Energji” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:
 - Formati dhe dokumentacioni për aplikim (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b” “c”) **është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.**
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”) **është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.**
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”), **është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.**
 - Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”) **është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.**

Për gjithë sa më sipër cituar bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “Tirana Energji” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5 vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI